

ROLI I PROMOVIMIT TË NDJENJËS SË PËRKATËSISË SHKOLLORE NË MIRËQENIEN
SUBJEKTIVE TË PËRGJITHSHME DHE NË MIRËQENIEN SUBJEKTIVE NË SHKOLLË
TEK NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME TË ULËT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM
NGA
ERBLINA VRBOVCI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Mentore: Prof. Asoc. Kaltrina Kelmendi

Kandidatja: Erblina Vrbovci

Prishtinë, Shtator 2023

Ky hulumtim kishte për qëllim që të analizonte ndërlidhshmërinë ndërmjet ndjenjës së përkatësisë shkollore me mirëqenien subjektive shkollore dhe me mirëqenien subjektive të përgjithshme, dhe qëllimi tjetër ishte që analizoheshin ndryshimet në mirëqenien subjektive të përgjithshme dhe në mirëqenien subjektive shkollore pas zhvillimit të aktiviteteve mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore. Metodologjia e hulumtimit ishte kuantitative, me anketën si metodë, pyetësin si instrument dhe dizajnin e eksperimentit të vërtetë. Pjesëmarrës të këtij hulumtim ishin gjithsej 61 nxënës të klasave gjashtë dhe shtatë, të grupmoshave 11-13. Për matjen e ndjenjës së përkatësisë shkollore është përdorur nënshkalla mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore nga Panorama Student Survey (Panorama Education, 2015), për matjen e mirëqenies subjektive të përgjithshme është përdorur nënshkalla e mirëqenies subjektive, të pyetësit mbi portfolion e reziliencës (Hamby et al., 2015), dhe për qëllim të matjes së konceptit të mirëqenies subjektive shkollore është përdorur pyetësi Student Subjective WellBeing Questionnaire (Renshaw et al., 2015).

Synim i këtij hulumtimi ishte që të i ofronte përgjigje fillimisht dy pyetjeve kërkimore të cilat parashtronin ndërlidhshmërinë ndërmjet ndjenjës së përkatësisë shkollore me mirëqenien subjektive të përgjithshme dhe ndërlidhshmërinë ndërmjet ndjenjës së përkatësisë shkollore dhe mirëqenies subjektive shkollore tek nxënësit. Pastaj, dy pyetjet e tjera kërkimore synonin të paraqesnin dallimet në matjet pre dhe post në konstruktin e mirëqenien subjektive të përgjithshme dhe në mirëqenien subjektive shkollore tek nxënësit të grupit eksperimental dhe së fundmi dy pyetjet e tjera kërkimore synonin që të paraqesnin dallimet në konstruktin e mirëqenies subjektive të përgjithshme dhe mirëqenies subjektive shkollore tek nxënësit pjesëmarrës dhe jo pjesëmarrës në aktivitetet mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore. Nga këto gjashtë pyetje kërkimore u ngritën rrjedhimisht këto gjashtë hipoteza:

H1: Ekziston një ndërlidhshmëri pozitive ndërmjet ndjenjës së përkatësisë shkollore dhe mirëqenies subjektive të përgjithshme tek nxënësit.

H2: Ekziston një ndërlidhshmëri pozitive ndërmjet ndjenjës së përkatësisë shkollore dhe mirëqenies subjektive shkollore tek nxënësit.

H3: Nxënësit pjesëmarrës në aktivitetet mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore do të kenë mirëqenie subjektive të përgjithshme më të lartë pas zhvillimit të aktiviteteve në krahasim me mirëqenien subjektive të përgjithshme para zhvillimit të aktiviteteve.

H4: Nxënësit pjesëmarrës në aktivitetet mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore do të kenë mirëqenie subjektive shkollore më të lartë pas zhvillimit të aktiviteteve në krahasim me mirëqenien subjektive shkollore para zhvillimit të aktiviteteve.

H5: Nxënësit pjesëmarrës në aktivitetet mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore do të kenë mirëqenie subjektive të përgjithshme më të lartë në krahasim me nxënësit jo pjesëmarrës në këto aktivitete.

H6: Nxënësit pjesëmarrës në aktivitetet mbi ndjenjën e përkatësisë shkollore do të kenë mirëqenie subjektive shkollore më të lartë në krahasim me nxënësit jo pjesëmarrës në këto aktivitete.

Në bazë të analizës korrelacionale u tregua se ekziston një ndërlidhshmëri pozitive signifikante e moderuar në mes variablave të ndjenjës së përkatësisë shkollore dhe të mirëqenies subjektive shkollore $r(59) = .643, p = .000$. Kjo nënkupton se me rritjen e ndjenjës së përkatësisë shkollore rritet edhe mirëqenia subjektive shkollore tek nxënësit dhe anasjelltas. Poashtu, rezultatet treguan se ka një ndërlidhshmëri negative të ulët signifikante në mes variablave të ndjenjës së përkatësisë shkollore dhe mirëqenies subjektive të përgjithshme $r(59) = -.275, p = .037$. Ndër faktorët potencial për këtë ndërlidhshmëri negative mund të jetë presioni i lartë i

bashkëmoshatarëve në këtë periudhë zhvillimore e cila dërgon edhe te konformizmi dhe prioritizimi i kërkesave të grupeve sociale në krahasim me ato individuale. Poashtu, faktor tjerë i mundshëm për këtë ndërlidhshmëri qëndron në idenë se nxënësit të cilat kanë një ndjenjë më të lartë të përkatësisë shkollore kanë një tendencë për performancë më të lartë akademike e cila në anën tjetër dërgon deri tek uljen e mirëqenies subjektive.

Rezultatet paraqitën dallimet në matjet e intervenimit në variablën e mirëqenies subjektive shkollore mes matjes para intervenimit ($M=3.1142$, $DS=.54206$) dhe matjes pas intervenimit ($M=3.1552$, $DS=.53338$) ku analiza paired sample t-test tregon se ka një ngritje të ulët jo të rëndësishme në mirëqenien subjektive shkollore pas intervenimit $t(28)=-.814$, $p=.423$, dhe poashtu janë paraqitur dallimet në matjet e intervenimit në mirëqenien subjektive të përgjithshme mes matjes para intervenimit ($M=1.7931$, $DS=.56680$) dhe pas intervenimit ($M=1.8223$, $DS=.69264$) ku analiza paired sample t-test tregon se ka një ngritje të ulët jo të rëndësishme në mirëqenien subjektive të përgjithshme pas intervenimit $t(28)=-.567$, $p=.575$. Këto rezultatet demonstronë se përkundrazi faktit se ka patur ngritje në mesataret, sërish ato nuk ishin të rëndësishme. Faktorë potencial për këto rezultatet mund të jenë periudha e zhvillimit të aktiviteteve që ishte periudhë testimesh e vlerësimesh, kohëzgjatja e shkurtë e intervenimit dhe mospërfshirja e më shumë variablove.

Rezultatet e tjera paraqitën dallimet e grupit eksperimental ($M=3.16$, $DS=.533$) dhe grupit kontrollues ($M=3.36$, $DS=.479$) pas intervenimit në variablën e mirëqenies subjektive shkollore, ku analiza independent sample t-test tregon që ka dallime jo të rëndësishme në mirëqenien subjektive shkollore mes grupeve $t(57)=-1.541$, $p=.129$, si dhe dallimet e grupit eksperimental ($M=1.81$, $DS=.687$) dhe grupit kontrollues ($M=1.62$, $DS=.643$) pas intervenimit në variablën e mirëqenies subjektive të përgjithshme, ku analiza independent sample t-test tregon

që ka dallime jo signifikante në mirëqenien subjektive të përgjithshme mes grupeve $t(58)=1.075$, $p=.287$. Faktorë të mundshëm për këto rezultate mund të jenë një numër i konsiderueshëm i largimit të matjeve në posttest si rezultat i mospërputhjeve me matjet pre dhe fenomenit të dëshirueshmërisë social tek grupi kontrollues.

Ky hulumtimi ofroi edhe disa rekomandime në raport me ngritjen e niveleve të këtyre konstrukteve të aplikueshme nga vetë nxënësit, prindërit, mësuesit dhe stafi shkollor në përgjithësi. Këto rekomandime përfshijnë zbatimin e strategjive dhe teknikave të tjera si dhe promovimin e këtyre konstrukteve me rëndësi për nxënësit. Në kuadër të limitimeve të këtij hulumtimi u përfshinë matjen e këtyre konstrukteve vetëm në bazë të vetë-raportimeve të nxënësve, një numër i vogël i mostrës që ndikon në mosgjeneralizim të rezultateve, periudha e shkurtë e zhvillimit të aktiviteteve dhe mos përfshirja e një matje follow up pas matjes së post testit.